

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë -Ministarstvo Pravde -Ministry of Justice

Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service

Drejtoria e Përgjithshme

PLANI PËR INTEGRITET
(2024 – 2026)

Përmbajtja

Deklarata e Integritetit.....	3
Përkufizimii termave	4
1. Hyrje.....	5
2. Përmbajtja e Planit të Integritetit.....	5
3. Objektivat dhe qëllimet e Planit të Integritetit.....	6
4. Procesi i hartimit të Planit të Integritetit.....	6-9
5. Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi.....	9
6. Fushat e Rrezikut.....	10
7. Pyetëtori.....	10
8. Tabela me fushat e përgjithshme dhe specifike të rrezikut.....	10-14

Deklarata e Integritetit

Përballja efektive me korrupsionin për të gjithë të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës është shumë e rëndësishme në arritjen e rezultateve sa më të larta në sundimin e ligjit si dhe forcimi e integritetit institucional, administrimin e mirë si dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira për të gjithë personat e privuar nga liria të cilët gjenden në mbajtje në institucionet korrektuese.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues të Kosovës ka përgjegjësinë kryesore të menaxhimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore, auditimin, transparencën, arkivimin, ruajtjen, administrimin e dokumenteve dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Duke pasur rolin qendror në këtë fushë, jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi të parët që të japim shembullin tonë në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me etikë dhe të bazuar në ligj. Ky plan i integritetit është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet, si dhe e qëndrimit aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reforma për antikorrupsionin.

Ky plan i integritetit përfshin rreziqet e integritetit sipas fushave funksionale në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe masave konkrete në adresimin e tyre. Qëllimi i këtij plani të integritetit është përmirësimi dhe forcimi i politikave të sundimit të ligjit, praktikave të parandalimit të korrupsionit si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Plani i integritetit për Shërbimin Korrektues të Kosovës do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të shërbimeve për personat që kanë rënë ndesh me ligjin të cilët gjenden në vuajtje të dënimeve në institucionet korrektuese.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues të Kosovës ka këto prioritetet:

- Forcimi i kapaciteteve organizative dhe funksionale në ekzekutimin e sanksioneve penale;
- Zhvillimi i programeve rehabilituese dhe ri integruese për burgosurit;
- Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Forcimi i bashkëpunimit me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve me theks të veçante në kujdesin e shëndetit mendor;
- Përmirësimi i llogaridhënies në të gjitha nivelet e Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Përmirësimi i infrastrukturës në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Përkufizimi i Termave

Integritet: ndershmëri individuale, sjellje në përpulhje me vlerat dhe parimet morale, integritetin institucional, përputhshmëri dhe qëndrueshmëri në veprime.

Rreziku në kontekstin e Planit të Integritetit: mundësia e shfaqjes së dëmit për shkak të ngjarjes së tashme apo të ardhme e cila rrezikon integritetin e një institucioni d.m.th. ndikim në shfaqjen e korrupsionit, praktika etike dhe profesionale të papranueshme dhe parregullsi tjera.

Ndikimi i rrezikut: vlera e dëmit për të mirën ose vlerën publike të mbrojtur (ndikimi i rrezikut mund të jetë i ulët, i mesëm ose i lart).

Probabiliteti-mundësia e rrezikut: pasoja e dëmit të shkaktuar ndaj një të mire ose vlere publike të mbrojtur (rreziku mund të jetë i ulët, i mesëm ose i lartë).

Vlerësimi i rrezikut: vlerësimi i gjendjes aktuale të ekspozimit të një institucioni ndaj një rreziku specifik në një fushë të caktuar, të një intensiteti të ulët, mesatar ose të lartë, dhe rezulton nga vlerësimi i ndikimit të rrezikut dhe probabiliteti i rrezikut.

Masa aktuale e menaxhimit të rrezikut: masë eventuale e aplikuar nga një institucion, e cila shërben për të reduktuar rreziqet e korrupsionit në një fushë të caktuar.

Masa e përmirësimit: masë e cila pas vlerësimit të masave të menaxhimit aktual të rrezikut, mund të reduktojë rrezikun e korrupsionit në një fushë/proces të caktuar.

Aktiviteti: veprimet që duhen ndërmarrë për zbatimin e masës së përmirësimit.

Fusha: një fushë kyçe në funksionimin e një institucioni d.m.th. në përmbushjen e mandatit të tij e cila për shkak të natyrës mund të jetë rrezik korrupsioni.

Procesi: një grup aktivitete të ndërlidhura të nevojshme për funksionimin brenda një fushe p.sh. kompetenca, ndërsa procesi është një term më specifik se fusha d.m.th. çdo fushë përbëhet nga një grup procesesh të lidhura.

Pyetësori: Është instrument kërkimor i dizajnuar për mbledhjen e informacioneve të nevojshme për arritjen e qëllimeve kërkimore të synuara.

1. Hyrje

Në pajtim me nenin 25 të ligjit nr.08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i integritetit është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e ceneshmërisë së integritetit brenda institucionit dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të institucionit.

Plani rritetson përkushtimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

2. Përmbajtja e Planit të Integritetit

Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejt i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu plani i integritetit përmban fusha të cilat konsiderohen si më të ekspozuara ndaj rreziqeve të korrupsionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit.

Në procesin e zhvillimit të këtij piani, fushat e identifikuara ndahen si në vijim:

1. Fushat e përgjithshme:

- 1.1.Fusha e menaxhimit të kontratave të lidhura me operatorët ekonomik;
- 1.2.Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- 1.3.Fusha e kontrollit për parandalimin e futjes së gjerave të palejuara në Institucionet Korrektuese dhe mekanizmave kundër korrupsionit;

2. Fushat specifike:

- 2.1.Prokurimi publik;
- 2.2.Monitorimi Institucioneve Korrektuese;
- 2.3.Mbikëqyrja e realizimit të beneficioneve për të burgosur.

3. Objektivat dhe qëllimet e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i planit të integritetit është të rrisë dhe rendit përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

3.1. Objektivat specifike janë:

- 3.1.1 Sigurimi i një mekanizmi ku të gjithë stafi i Shërbimit Korrektues të Kosovës si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e institucionit.
- 3.1.2. Rritja e vetëdijësimit mbi rreziqet e korrupsionit dhe sensibilizimi i publikut për rolin e tyre në parandalimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- 3.1.3. Përcaktimin i mekanizmit për raportimin e rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- 3.1.4. Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.
- 3.1.5. Bashkëpunimi me institucionet tjera relevante dhe akterë tjerë në luftën kundër korrupsionit.

3.2 Qëllimi i Planit të Integritetit:

- 3.2.1. Identifikimi i proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive;
- 3.2.2. Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- 3.2.3. Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- 3.2.4. Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- 3.2.5. Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

4. Procesi i hartimit të Planit të Integritetit

Plani i integritetit është një dokument që vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të planit të integritetit bëhet vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të institucionit. Personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës kanë mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut, të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

4.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit për Shërbimin Korrektues të Kosovës përbëhet prej fazave si në vijim:

Faza parë - Drejtori i Përgjithshëm ka themeluar grupin e punues me vendim për zhvillimin e planit të integritetit. Grupi punues me datë 27 nëntor 2023 ka mbajtur mbledhjen e parë, ku janë bërë shqyrtimet fillestar dhe koordinimi i antarëve të grupit lidhur me ecurinë e planit të integritetit, grupi punues ka mbajtur takime tjera konsultative dhe ka siguruar dokumentacione tjera relevante për hartimin e planit të integritetit.

Faza e dytë - Grupi punues ka përpiluar pyetësin gjithëpërfshirës i cili është plotësuar nga personeli i institucionit. Gjatë kësaj faze grupi punues mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale ka përcaktuar fushat e rrezikut duke bërë identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve.

Faza e tretë – Pas plotësimit të pyetësit nga personeli grupi ka mbajtur takimin e radhës ku është bërë përcaktimi i prioriteteve dhe propozimi i masave për përmirësimin e integritetit me qëllim të parandalimit/eliminimit të rreziqeve dhe përgjegjësit për zbatim të këtij plani.

4.2 Procesi i vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të Shërbimit Korrektues. Prandaj, prioritetet janë përcaktuar ashtu që resurset në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi rreziqet e kategorizuara si të vogla përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, grupi punues ka përcaktuar nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuar dhe të vlerësuara, duke përdorur matricën e rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

4.2.1 Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, aktivitet të Shërbimit Korrektues për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke përshkruar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur aktivitetin e Shërbimit Korrektues në rrugën duhur.

Figura I . Malrica e vlerësimit të rrezikut


Pasoja /Ndikimi	Madhor	10									
		9									
		8									
	Mesatar	7									
		6									
		5									
		4									
	Vogël	3									
		2									
		1									
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar			Lartë			
		Probabiliteti/Gjasat									


Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1 - 10) x pasoja (1 - 10)", të treguar në figurën si më tartë.


4.2.2 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga I deri ne 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

 Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

5. Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i planit të integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësim duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda institucionit, raporti dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

6. Fushat e rrezikut

Fushat e përgjithshme të Rrezikut

- Fusha e menaxhimit të kontratave të lidhura me operatorët ekonomik;
- Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Fusha e kontrollit për parandalimin e futjes së gjerave të palejuara në Institucionet Korrektuese dhe mekanizmave kundër korrupsionit.

Fushat specifike të rrezikut

- Prokurimi publik;
- Mbikëqyrja e realizimit të beneficioneve për të burgosur.

7. Pyetëtori

Në kuadër të zhvillimit të planit të integritetit Shërbimi Korrektues ka hartuar pyetësin, ku kanë marr pjesë 50 pjesëmarrës, punonjës të Shërbimit Korrektues ku janë përfshirë udhëheqësit e Institucioneve Korrektuese dhe stafi i tyre dhe nga të dhënat që kanë dal nga ky pyetësor rezulton së Shërbimi Korrektues qëndron mirë në aspektin organizativ dhe përgjegjësi të ndara në departamente dhe divizione. Të dhënat e marra nga pyetësi janë pasqyruar në fushat e përgjithshme të rrezikut dhe fushat e specifike të rrezikut. Në kuadër të planit të integritetit ku janë paraqitur në formën tabelare fushat e rrezikut të ndarë në dy pjesë, në formën diagonale është bashkëngjitur edhe pyetësi me përqindje të rezultateve të fituara nga secila pyetje.

8. Tabela me fushat e përgjithshme dhe specifike të rrezikut

Në tabelën në vijim janë të paraqitura fushat e përgjithshme dhe specifike të rrezikut duke përfshirë përshkrimin e rrezikut, masat ekzistuese të kontrollit, vlerësimi dhe matja e rrezikut, masat e propozuara për zvogëlim/eliminim të rreziqeve, njësia/personi përgjegjës dhe afati i realizimit të veprimit ndaj rrezikut.

Planit i Integritetit										
Fushat e përgjithshme të rrezikut										
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut				
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit		
Menaxhimi i kontratave	Mungesa e trajnimit të menaxherve të kontratave	Plani aktual i trajnimit lidhur me menaxhimin e kontratave.	3	7	21	Rishikimi i planit të trajnimit	Divizioni Burimeve Njerëzore SHKK	TMI-2024		
	Mosrespektimi i procedurave të pranimit të mallit nga operatorët ekonomik	Kontrolli administrative i brendshëm/ auditori i brendshëm/ auditori i jashtëm	2	9	18	Rritja e kontrollit	SHKK, Auditorët	2024-2026		
	Veshtërsitë në menaxhimin e kontratave të prokurimit	Ligjet dhe aktet nënligjore	3	7	21	Trajnimi i menaxherëve ekzistues të kontratave	Divizioni Burimeve Njerëzore SHKK	2024-2026		


Menaxhimi i burimeve njerëzore	Klasifikimi i vendeve të punës	Ligji për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Ligji Zyrtarët Publik	1	4	4	Miratimi i Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Brandshëm të Shërbimit Korrektues	Qeveria e Republikës së Kosovës	TM2-2024
	Mos definimi i vendeve të punës sipas kualifikimit dhe pozitave	Ligji për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Ligji Zyrtarët Publik	2	6	12	Miratimi i Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Brandshëm të Shërbimit Korrektues	Qeveria e Republikës së Kosovës	TM2-2024
	Mungesa e trajnimeve për stafin menaxherial	Plani aktual i trajnimit	2	5	10	Rishikimi planit aktual të trajnimeve dhe planifikimet shtesë për trajnim	Divizioni Burimeve Njerëzore SHKK	2024-2026
Mungesa e shtesës në pagë për Rrezikshmeri në punë për personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës	Ligjet dhe aktet ligjore	4	8	32	Aprovimi i shtesës për rrezikshmeri për personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës	Komisioni qeveritar për trajtimin e kërkesave për kushtet specifike të punë	TM2-2024	

Fusha e kontrollit për parandalimin e futjes së gjerave të palejuara në institucionet korrektuese dhe mekanizma kundër korrupsionit	Kontrollimi i duhur për detektimin e gjësëve të palejuara gjatë hyrjes në ambientet e institucioneve korrektuese	Rregullat e brendshme të sigurisë	5	9	45	Rishikimi i përshkrimit të detyrave të vendit të punës	Departamenti për Siguri Operativë Institucioni Korrektues përkatës	TM2-2024
	Monitorimi i rregullt i punës dhe veprimit të institucioneve korrektuese	Plani i kontrollit	3	6	18	Shimi i numrit të vizitave për kontroll në Institucionet Korrektuese	Drejtoria Përgjithshme e SHKK	2024-2026

Fushat e veçanta të rrezikut

Regjistrimi i rrezikut		Vlerësimi dhe matja e rrezikut		Veprimi ndaj rrezikut				
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
	Prokurimi Publik	Mungesa e stafit kualifikuar për menaxhimin e kontratave	Ligjet dhe aktet nënligjore	4	7	28	Krijimi i divizionit për menaxhimin e kontratave	Qeveria e Republikës së Kosovës

	Përgatitja e efikasave specifike teknike të projekteve	Komisioni për vlerësimin e specifikeve	2	6	12	Caktimi zyrtarëve profesional në komisionin për vlerësimin e specifikeve	Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Ekzekutive	2024-2026
Mbikëqyrja e realizimit të beneficioneve për burgosur	Përfshirja e zyrtarëve profesionalë në ekipin multidisiplinor për trajtimin e kërkesave të burgosurve për realizimin e beneficioneve	Paneli për trajtimin e kërkesave për beneficione	4	5	20	Mbikëqyrja e rekomandimeve të panelit për beneficione	Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë Ekzekutive	2024-2026
Mungesa e informacionit me kohë për plotësimin e kriterëve për parashtrimin e kërkesave për realizimin e beneficioneve	Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtepiak në Insitucionet Korrektuese	Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtepiak në Insitucionet Korrektuese	2	7	14	Shpërndarja e broshurave informuese për kriteret e realizimit të beneficioneve	Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë Ekzekutive	2024-2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Korrektional Service
Drejtoria e Përgjithshme

Prishtinë: 26/01/2024

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, në bazë të nenit 12 paragraf 1, nën paragraf 1.10 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, nenit 25 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit sipas vendimit Nr. 1476/23 datë 26/07/2023, si dhe bazuar në propozimin e koordinatorit të grupit punues të themeluar sipas vendimit Nr.1090 datë 22/08/2023 për miratimin e planit të integritetit për Shërbimin Korrektues të Kosovës, nxjerr:

V E N D I M

- 1.Miratohet plani i integritetit për Shërbimin Korrektues të Kosovës për periudhën 2024-2026;
2. z. Visar Morina, Zyrtar i Lartë Ligjor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të planit të integritetit;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.


A r s y e t i m

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura për miratimin e Planeve të Integritetit.

Duke e marrë parasysh rëndësinë dhe qëllimin e hartimit dhe të miratimit të planit të integritetit, si një dokument i cili paraqet rezultatin e vetëvlerësimit të ekspozimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës ndaj korrupsionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit, qëllimi i të cilit është të ruajë dhe përmirësojë integritetin e institucionit duke thjeshtuar procedurat, duke forcuar llogaridhënien, kontrollin e kompetencat diskrecionale, edukimin, forcimin e etikës, krijimin e një sistemi efektiv kontrolli dhe eliminimin e praktikave joefikase.

Grupi punues i themeluar sipas vendimit Nr.1090 datë 22/08/2023 ka hartuar planin e integritetit për Shërbimin Korrektues të Kosovës për periudhën 2024-2026 duke përcaktuar fushat e përgjithshme dhe specifike të rrezikut si dhe ka propozuar masat konkrete në raport me këto fusha, andaj nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ismail Dibrani



Drejtore i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Personit përgjegjës;
- Arkivës.